

**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Specialist per ruajtjen e te dhenave back up dhe administrator	Rep.Usht. 6640	Tirane	3-mujore	po	jo	24.11.2023	08.12.2023

Formulari nr. 1

<p><b>1.Pozicioni i punës:</b> Specialist per ruajtjen e te dhenave backup dhe administrator</p>
<p><b>2. Kodi i pozicionit:</b> ND3420</p>
<p><b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak nr. 6640</p>
<p><b>4. Vendi:</b> Rruga Rexhep Tarja, rrapi i treshit, Tiranë</p>
<p><b>5. Paga:</b> Vendim i KM nr; 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve tëb tjerë të specialitetve të ndryshme”</p>
<p><b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> 3-mujore.</p>
<p><b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 24.11.2023</p>
<p><b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 08.12.2023</p>
<p><b>9. Mënyra e aplikimit:</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t’i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse):</p>

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike eëë. mod.gov.al. (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil C2
- b. Arsimi: i mesëm ose i lartë ( i preferuar të kete eksperience të meparshme te ngjashme)
- c. Kualifikimi: kurse te programeve baze kompjuterike, kurse ne fushen e TIK
- d. Trajnime:
- e. Eksperienca në Punë: Te kete kryer detyra te ngjashme si teknik, administrator rrjetesh backup, etj
- f. Gjuha e huaj: 2/2/2/2
- g. Kërkesa të tjera specifike:
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: S

## 13. Përshkrimi i punës:

- Është përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e te dhenave te sistemeve te instaluara dhe implementuara ne FA.
- Të njohë konceptet baze, operimin dhe konfigurimin e swich-eve dhe ruoterave.

- Të njohje arkitekturën e rrjeteve dhe dizejimin e swich-eve dhe ruoterave, ne rrjet.
- Të kete njohuri shume te mira per sistemet e nderlidhjes dhe informacioni per rrjetet kompjuterike LAN/WAN.

#### **14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kerkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- Vlersimi i dosjes.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.